



KËSHILLI DREJTUES

**V E N D I M**

**Nr. 06, datë 27.02.2019**

**Për miratimin e raportit vjetor të**

**Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2018**

Në mbështetje të nenit 7, nenit 52 pika 1, shkronja “l”, dhe nenit 53 pika 5, shkronja “e” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

---

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë Raportin Vjetor të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2018, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për paraqitjen e tij pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Autoritetit Mbikëqyrës, sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e Raportit Vjetor në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

**Sekretar**

Donald Duraj

**Kryetar**